



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 18.11.2021

**Lënda:** Parashtrime të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 18.11.2021, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 332, datë 12.1.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Lindita Male (Ziguri)

**Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

1. Kolegji i Posaçëm i Apelit ka zhvilluar në datat 20.10.2021 dhe 26.10.2021 seancat gjyqësore publike të çështjes (JR) 21/2021, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 332, datë 12.1.2021, që lidhet me subjektin e rivlerësimit Lindita Male (Ziguri).

1.1 Në seancën e datës 20.10.2021, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kundërshtimet e saj në përgjigje të secilit prej shkaqeve të ankimit, si dhe ka paraqitur akte të reja. Trupi gjykues i Kolegjit vendosi të çelë hetimin gjyqësor të çështjes dhe të pranojë në cilësinë e provës këto akte.

1.2 Në seancën e datës 26.10.2021, pas administrimit të parashtrimeve të Komisionerit Publik, lidhur me nevojat e hetimit, por edhe pas vlerësimit *ex officio* për nevojën e kryerjes së disa veprimeve hetimore, me vendim të ndërmjetëm, trupi gjykues vendosi të zhvillojë hetime të mëtejshme lidhur me çështjen dhe të kërkojë informacion dhe dokumentacion nga subjekte/institucione lidhur me fakte dhe rrethana që i përkasin çështjes.

1.3 Kolegji i Posaçëm i Apelit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2021, ka përcjellë shkresën nr. \*\*\* regj., datë \*\*.11.2021, të gjyqtarës kryesuese të çështjes (JR) nr. 21/2021, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 332/2021, bashkëlidhur së cilës janë përcjellë kopje të njësuara me vulën e sekretarisë së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, të kërkesave për informacion dhe kthimet e përgjigjeve, si vijon:

- Kërkesë për informacion nr. \*\*\* regj, datë \*\*.10.2021, drejtuar shoqërive “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh.p.k., e përcjellë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2021, dhe kthimet e përgjigjeve

të shoqërive, të datës \*\*.11.2021, protokolluar përkatësisht me nr. \*\*\* prot. dhe nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2021 (46 fletë);

- Kërkesë për informacion nr. \*\*\* regj., datë \*\*.10.2021, drejtuar Bankës \*\*\* sh.a., e përcjellë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2021, dhe kthim përgjigje me nr. prot., \*\*\*, datë \*\*.11.2021 (3 fletë);

- Kërkesë për informacion nr. \*\*\* regj., datë \*\*.10.2021, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, e përcjellë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2021, dhe kthim përgjigje me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2021 (16 fletë);

- Kërkesë për informacion nr. \*\*\* regj., datë \*\*.10.2021, drejtuar Agjencisë së Trajtimit të Kredive, e përcjellë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2021, dhe kthim përgjigje me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2021 (4 fletë);

- Kërkesë për informacion nr. \*\*\* regj., datë \*\*.10.2021, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e përcjellë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2021, dhe kthim përgjigje me nr.\*\*\* prot., datë \*\*.11.2021 (4 fletë);

- Kërkesë për informacion nr. \*\*\* regj., datë \*\*.10.2021, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, e përcjellë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2021, pa përgjigje (2 fletë).

**2.** Komisioneri Publik, pasi vlerësoi aktet e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, znj. Male (Ziguri), në seancën e datës 20.10.2021, si dhe aktet e përcjella nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, në datën 16.11.2021, në raport me shkaqet e ankimit, konstaton sa vijon:

**3.** *Lidhur me aktivitetin tregtar të personit të lidhur (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit) në periudhën 2005-2007 dhe çështje të lidhura me të*

**3.1** Subjekti i rivlerësimit ka depozituar aktet si vijon:

**3.1.1** Shkresë nr.\*\*\* prot., datë \*\*.10.2020, e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), Drejtoria Vendore Tirana Jug, drejtuar z. \*\*\*.\*\*\*, e cila informon se: [...].*... leja e ndërtimit nr. \*\*\*, datë \*\*.5.2004, është miratuar në favor të subjektit ndërtues “\*\*\*” sh.p.k., por që me kontratën nr.\*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.9.2014, kjo shoqëri ia ka kaluar të drejtat reale dhe pasurore shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., që kjo e fundit të kryejë procedurat ligjore të legalizimit [...].*

**3.1.2** Shkresë nr. \*\*\* prot., datë \*\*.4.2021, e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), Drejtoria Vendore Tirana Jug, drejtuar z. \*\*\*.\*\*\*, bashkëlidhur praktika e legalizimit të objektit në rrugën “\*\*\*”, Tiranë, nga ku rezulton se kërkesa për legalizim<sup>1</sup> për këtë objekt është kryer nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., me përfaqësuese ligjore znj. \*\*\*.\*\*\*.

**3.1.3** Shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë nr. \*\*\* prot., datë \*\*.9.2021, drejtuar subjektit të rivlerësimit, e cila informon se për periudhën kohore 2007-2021 nuk rezultoi që prokurori Lindita Ziguri të ketë ndjekur materiale kallëzuese për subjektin \*\*\*.\*\*\*.

---

<sup>1</sup> Nr. \*\*\* prot. \*\*\*, datë \*\*.11.2006.

3.1.4 Shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2021, drejtuar subjektit të rivlerësimit, e cila informon se për periudhën kohore 2007-2021 nuk rezultoi që prokurori Lindita Ziguri të ketë hetuar shtetasit \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*.

3.1.5 Shkresë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë nr.\*\*\* prot., datë \*\*.10.2021, drejtuar subjektit të rivlerësimit, e cila informon se për periudhën kohore 2007 e në vazhdim nuk rezulton të ketë çështje civile të regjistruara me objekt “Kthim shume”, me palë shtetasit \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*.

3.2 Nga aktet e përcjella nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2021, lidhur me këtë shkak ankimi rezulton se:

3.2.1 Referuar shkresave “Kthim përgjigje”, të shoqërive “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh.p.k., protokolluar nga Kolegji përkatësisht me nr. \*\*\* prot. dhe nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2021, bashkëlidhur është administruar Deklarata noteriale nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*.11.2021 e shtetasve \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*, të cilët deklarojnë se: *[...]... Në datën \*\*.7.2005, kur niveli i zbatimit të punimeve të ndërtimit arriti në kuotën +6,12, është vetofruar z. \*\*\*.\*\*\*, në cilësinë e investitorit, dhe është lidhur kontratë bashkëpunimi për sipërmarrje ndërtimi nr. \*\*\* rep., dhe nr. \*\*\* kol., datë \*\*.7.2005, e cila nuk u zbatua nga pala e vetofruar, z. \*\*\*.\*\*\* Nga ana e shtetasit \*\*\*.\*\*\*, qoftë në cilësinë e shoqërisë tregtare “\*\*\*\*” sh.p.k., qoftë si individ, nuk ka investuar asnjë vlerë monetare, nuk ka investuar as me materiale apo mënyra të tjera të njohura nga ligji për ndërtimin e objektit apo veprime të tjera juridike. Nuk ka kryer asnjë shitje të ambienteve dhe nuk ka përfituar nga këto shitje. Nga ana e shtetasit \*\*\*.\*\*\*, në çfarëdolloj cilësie, që prej vitit 2004, nuk janë ngritur asnjëherë pretendime në asnjë lloj forme në lidhje me objektin e ndërtuar. ...me bashkëshorten nuk kemi pasur asnjë lloj marrëdhënie juridike, qoftë para gjykatës, prokurorisë apo privatisht, edhe po kështu edhe me shtetasin \*\*\*.\*\*\* [...].*

3.2.2 Banka \*\*\* sh. a., me shkresën nr. prot., \*\*\*, datë \*\*.11.2021, drejtuar Kolegjit, informon se shtetasi \*\*\*.\*\*\* dhe shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. nuk kanë qenë kredimarrës pranë kësaj banke.

3.2.3 Referuar informacionit të përcjellë në Kolegji nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me shkresën nr.\*\*\* prot., datë \*\*.11.2021, nuk rezulton ndonjë çështje gjyqësore me palë paditëse z. \*\*\*.\*\*\* dhe palë të paditur z. \*\*\*.\*\*\*.

3.2.4 Kolegji, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2021, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, ka kërkuar informacion nëse subjekti i rivlerësimit, znj. Ziguri, gjatë ushtrimit të detyrës si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, ka trajtuar çështje penale apo materiale kallëzuese, në të cilat të kenë qenë të përfshirë shoqëritë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe/ose përfaqësuesit ligjorë të këtyre dy subjekteve, përkatësisht shtetasit \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*, gjatë periudhës kohore janar 2005 – dhjetor 2006. Lidhur me këtë kërkesë nuk është përcjellë pranë IKP-së përgjigje nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.

3.3 Sa më sipër, Komisioneri Publik, referuar akteve të sipërcituara të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegji, konstaton se: (i) Me gjithë veprimet ligjore dhe financiare të ndërmarra prej tij, nuk rezulton që personi i lidhur, z. \*\*\*.\*\*\*, të ketë qenë në cilësinë e investitorit apo përfituesit të të ardhurave të gjeneruara nga shitja e pasurive në godinën e banimit, të ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë; (ii) Nuk rezulton që shtetasi \*\*\*.\*\*\* të ketë çështje civile të regjistruara

me objekt “Kthim shume”, kundrejt z. \*\*\*.\*\*\*, në cilësinë e palës së paditur; (iii) Në gjendjen që janë aktet, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të jetë ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës së saj si prokurore, me shtetasit e sipërcituar, \*\*\*.\*\*\*, \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*, për periudhën kohore 2007-2021, kjo për sa kohë nuk është administruar përgjigje lidhur me shoqëritë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe/ose përfaqësuesit ligjorë të këtyre dy subjekteve, përkatësisht shtetasit \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*, gjatë periudhës kohore janar 2005 – dhjetor 2006.

#### 4. Lidhur me huamarrjen në periudhën 1993-1994, të personit të lidhur, z. \*\*\*.\*\*\*

4.1 Subjekti i rivlerësimit, për të provuar mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit me palët huadhënëse, në seancën e datës 20.10.2021, ka depozituar aktet si vijon:

4.1.1 Korrespondencë me *email* me Kancelaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Përmet, znj. \*\*\*.\*\*\*, me drejtuesin e Prokurorisë Përmet, z. \*\*\*.\*\*\*, dhe me përmbartuesin shtetëror, dega Përmet, z. \*\*\*.\*\*\* (verifikuar dhe vërtetuar para noterit).

4.1.2 Gjashtë vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Përmet, ku personi i lidhur \*\*\*.\*\*\* është në cilësinë e të paditurit, më konkretisht: (i) Vendimi nr. \*\*\*, datë \*\*.11.2001, me paditës z. \*\*\*.\*\*\*; (ii) Vendimi nr. \*\*\*, datë \*\*.12.1994, me paditës \*\*\*.\*\*\*; (iii) Vendimi nr. \*\*\*, datë \*\*.4.1995, me paditës \*\*\*.\*\*\*; (iv) Vendimi nr. \*\*\*, datë \*\*.6.1995, me paditës \*\*\*.\*\*\*; (v) Vendimi nr. \*\*\*, datë \*\*.8.1995, me paditës \*\*\*.\*\*\*; (vi) Vendimi nr.\*\*\*, datë \*\*.12.1995, me paditës \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*.

4.1.3 Tri vërtetime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Përmet (vërtetim nr. \*\*\* prot.; nr. \*\*\* prot.; dhe nr. \*\*\* prot., të datës \*\*.4.2021), të cilat vërtetojnë se nga shtetasit \*\*\*.\*\*\*, \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\* nuk ka kërkesë të paraqitur për lëshim urdhër ekzekutimi, për vendimet gjyqësore të sipërcituara, për të cilët padia është pranuar.

4.1.4 Përgjigje nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2021, dhe nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2021, drejtuar subjektit të rivlerësimit, sipas së cilave, për periudhën 2000 – 2021, nuk rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Ziguri, të ketë ndjekur materiale hetimore me subjekte të listës së huadhënësve, të paraqitur prej saj.

4.1.5 Përgjigje nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Përmet nr.\*\*\* prot., datë \*\*.4.2021, sipas të cilës, nga verifikimet e kryera në arkivin e Gjykatës së Shkallës së Parë, Përmet, nuk rezultojnë kërkesa për gjykim të shtetasve huadhënës, ndërkohë arkivi i Prokurorisë Përmet, përpara vitit 1997, është djegur.

4.1.6 Tri vërtetime të Zyrës Përmbartimore Përmet (Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë \*\*.4.2021; Vërtetime nr. \*\*\* prot., dhe nr. \*\*\* prot., datë \*\*.4.2021), të cilat vërtetojnë se nga shtetasit \*\*\*.\*\*\*, \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\* nuk rezulton të jenë depozituar urdhër ekzekutimi apo të ndodhet dosje përmbartimore, për sa i përket vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë, Përmet lidhur me këta shtetas.

4.2 Nga aktet e përcjella nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2021, lidhur me këtë shkak ankimi, rezulton se:

4.2.1 Në gjendjen që janë aktet, nuk është përcjellë pranë IKP-së përgjigje nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, lidhur me kërkesën dërguar nga ky trup gjykues, nëse subjekti i rivlerësimit, gjatë ushtrimit të detyrës si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së

Parë, Tiranë, ka trajtuar çështje penale apo materiale kallëzuese, në të cilat të kenë qenë të përfshirë shtetasit \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\* (shtetas, të cilët rezultojnë si huadhënës të personit të lidhur, z. \*\*\*.\*\*\*).

4.3 Komisioneri Publik rezervon të drejtën për t'u shprehur lidhur me përmbajtjen e këtyre akteve pas administrimit të përgjigjes nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, në momentin procedural përkatës të këtij shqyrtimi gjyqësor.

5. *Lidhur me huamarrjen në shumën 5.000 euro, në muajin prill të vitit 2008, deklaruar si burim krijimi për pasurinë "Apartament banimi me sip. 68.8 m<sup>2</sup>, Tiranë"*

5.1 Lidhur me këtë shkak ankimi, në parashtrimet e depozituara në seancën e datës 20.10.2021, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se të ardhurat e ligjshme të familjes \*\*\* justifikojnë mundësinë për të dhënë hua shumën 5.000 euro. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se një prej fëmijëve të huadhënësit, prej vitesh, është rezident në SHBA dhe, jo vetëm që nuk është pjesë e shpenzimeve familjare, por ka kontribuar për familjen e origjinës. Për këtë kontribut financiar të pretenduar, subjekti nuk paraqiti prova/dokumentacion provues, ndërsa për të provuar jetesën e shtetasës \*\*\*.\*\*\* (vajza e huadhënësit) në SHBA ka depozituar aktet si vijon:

5.1.1 Certifikatë natyralizimi në emër të \*\*\*.\*\*\* (GJ.), me datëlindje \*\*.6.1982, nr. \*\*\*, nr. \*\*\*, në Filadelfia, Pensilvani, më \*\*.8.2008, vërtetuar dhe përkthyer nga noteri publik \*\*\*.\*\*\*.

5.1.2 Pasaportë nr. \*\*\*, lëshuar në SHBA, në emër të \*\*\*.\*\*\*, lëshuar në datën \*\*.10.2011, vërtetuar dhe përkthyer nga noteri publik \*\*\*.\*\*\*

5.2 Kolegji, në seancën e datës 26.10.2021, me vendim të ndërmjetëm, vendosi t'i drejtohej, për informacion dhe dokumentacion, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, mbi gjendjen familjare të huadhënësit, për vitet 2005-2008.

5.3 Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2021, ka përcjellë certifikatën familjare të familjes \*\*\*, nga ku rezulton se, për periudhën 2005-2008, familja \*\*\* përbëhej nga 6 anëtarë.

5.4 Komisioneri Publik, pasi analizoi parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, të datës 20.10.2021, aktet e depozituara nga subjekti, si dhe informacionin e përcjellë nga DPGJC-ja, duke i analizuar në harmoni këto akte, vëren se, nisur nga fakti që shtetasja \*\*\*.\*\*\* është natyralizuar në datën \*\*.8.2008, duket se ka qenë rezidente në këtë shtet, megjithëse mbetet e paqartë koha e largimin të saj në SHBA.

5.5 Komisioneri Publik vëren, gjithashtu, se edhe në konsideratë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, se familja \*\*\* përbëhej nga 5 anëtarë, përsëri rezulton se të ardhurat e ligjshme të realizuara nga familja e huadhënësit nuk janë të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve familjare dhe për t'i dhënë hua subjektit shumën 5.000 euro<sup>2</sup>.

---

<sup>2</sup> Nga aktet në dosje të Komisionit rezulton se të ardhurat dhe shpenzimet e familjes \*\*\*, për vitet 2005 - mars 2008 paraqiten:  
- Për vitin 2005, të ardhurat *bruto* të \*\*\*. & \*\*\*.\*\*\* nga "\*\*\*\*.\*\*\*" sh.p.k. dhe "\*\*\*\*" sh.p.k. janë në total 480.000 lekë, ndërsa shpenzimet e jetesës për një familje me 5 anëtarë llogariten në vlerën 547.785 lekë.  
- Për vitin 2006, të ardhurat *bruto* të \*\*\*.\*\*\*; \*\*\*. dhe \*\*\*.\*\*\* nga "\*\*\*\*.\*\*\*" sh.p.k. dhe "\*\*\*\*" sh.p.k., në total janë në shumën 782.000 lekë, ndërsa shpenzimet e jetesës për një familje me 5 anëtarë llogariten në vlerën 547.785 lekë.  
- Për vitin 2007, paga bruto e \*\*\*.\*\*\* është në shumën 168.000 lekë; \*\*\*.\*\*\*, në shumën 168.000 lekë; \*\*\*.\*\*\*, në shumën 168.000 lekë, ndërsa pagat e \*\*\*.\*\*\*, nga "\*\*\*\*" sh.p.k. dhe "\*\*\*\*.\*\*\*" sh.p.k., bazuar në vërtetimet e ISSH-së dhe nxjerrjen

**6. Lidhur me mungesën e një arsytimi për vlerësimin tërësor të kritereve të rivlerësimit**

**6.1 Subjekti i rivlerësimit ka depozituar aktet si vijon:**

6.1.1 Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Përmet nr. \*\*\*, datë \*\*.3.2002, me objekt: “Zëvendësim debitori (paditësit me të paditurin)”, me paditës \*\*\*.\*\*\*, i paditur \*\*\*.\*\*\* dhe personi i tretë Agjencia e Trajtimit të Kredive Tiranë.

6.1.2 Shkresë nga Agjencia e Trajtimit të Kredive nr. \*\*\* prot., datë \*\*.9.2021, bashkëlidhur së cilës gjendet akti “Kallëzim penal nr. \*\*\* prot., datë \*\*.2.2010, me kallëzues Agjencia e Trajtimit të Kredive kundër shtetasit \*\*\*.\*\*\*, për veprën penale të parashikuar nga neni 143/1, “Mashtrimi”, i Kodit Penal.

6.1.3 Shkresë nga Agjencia e Trajtimit të Kredive nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2021, bashkëlidhur së cilës gjendet shkresa e Ministrit të Financave nr. \*\*\* prot., datë \*\*.7.2002, drejtuar ATK-së, lidhur me parregullsitë për zëvendësimin e debitorit nga vendimi i Gjykatës Përmet nr.\*\*, datë \*\*.3.2002.

6.1.4 Vendim nr.\*\*\*, datë \*\*.3.2003, “Urdhër ekzekutimi i titullit ekzekutiv”, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Përmet, në favor të kreditorit Agjencia e Trajtimit të Kredive Tiranë, kundër debitorit \*\*\*.\*\*\*, me objekt: “Akt-detyrimin e huas të datës \*\*.9.1994, që i përket debitorit \*\*\*.\*\*\*”.

6.2 Nga aktet e përcjella nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2021, lidhur me këtë shkak ankimi rezulton se:

6.2.1 Përgjigjja nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2021, e Agjencisë së Trajtimit të Kredive, informon lidhur me procedurën e ndjekur për urdhrin e ekzekutimit për “Akt-detyrimin e huas të datës \*\*.9.1994, që i përket debitorit \*\*\*.\*\*\*”, e cila aktualisht është në fazën e sekuestros mbi llogaritë e debitorit \*\*\*.\*\*\*

6.3 Sa më sipër, Komisioneri Publik vëren se përgjigjja e ATK-së, e datës \*\*.11.2021, jep informacion mbi *akt-detyrimin e huas të datës \*\*.9.1994*, duke njohur si debitor në procedurën përmbare z. \*\*\*.\*\*\*, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit.

## **KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**

---

e llogarisë bankare të pagës, janë rreth 600.000 lekë. Pra, në total të ardhurat për këtë vit janë rreth 1.100.000 lekë, ndërsa shpenzimet e jetesës për një familje me 5 anëtarë llogariten në vlerën 1.179.840 lekë.

- Për periudhën janar - mars 2008, të ardhurat bruto të \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\* janë në shumën 144.000 lekë dhe të ardhurat e \*\*\*.\*\*\*, të kredituara në llogarinë bankare, janë në shumën 94.560 lekë. Pra, në total, të ardhurat janë rreth 238.000 lekë, ndërsa shpenzimet e jetesës janë në shumën 170.775 lekë.

Gjithashtu, nga aktet e depozituara nga subjekti në pyetësorin nr. 1 rezulton se z. \*\*\*.\*\*\* ka marrë një kredi pranë \*\*\* Bank, në datën \*\*.9.2007 (nuk ka informacion lidhur me qëllimin/destinacionin e kredisë), si dhe ka kryer pagesa të kësteve të kredisë.